



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, më 7 korrik 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

| | | |
|----------------|-----------------|------------------------|
| Armela | KRASNIQI | Kryetar |
| Desada | METAJ | Zëvendëskryetar |
| Aurela | BICJA | Anëtar |
| Besian | ZOGAJ | Anëtar |
| Gjergji | HAMITI | Anëtar |
| Jetmir | HALILAJ | Anëtar |
| Joana | ALLUSHI | Anëtar |

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Përcaktimin e masës së shpërblimit për pjesëmarrje në Sekretariatit Teknik të AMA-s. **(Vendimi nr. 55, datë 07.07.2023).**
2. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 181, datë 11.09.2017 të AMA-s “Për miratimin e rregullores ‘Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes’”. **(Vendimi nr. 56, datë 07.07.2023).**
3. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a., me NIPT K11715005L, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Vodafone TV”, me zonë ofrimi shërbimi: *Qarku Tiranë dhe Fier, Bashkia Peqin, Qyteti Vlorë, Shkodër, Durrës,, Elbasan, Krujë, Fushë-Krujë, Pogradec, Njësitë administrative Korçë, Berat, Maliq, Libonik, Pirg, Pojan, Vreshtas, Gramsh, Pishaj Kodovjat, Orikum dhe Velipojë*, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendimi nr. 57, datë 07.07.2023).**
4. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 5 datë 13.06.2023 të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve për dënimin me gjobë, në masën 40.000 (dyzet mijë) lekë, të shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat “Saranda ime Radio” **(Vendimi nr. 58, datë 07.07.2023).**
5. Miratimin e ndryshimeve të kategorizimit të pozicioneve të punës në strukturën organizative të Autoritetit të Mediave Audiovizive sipas VKM-së nr. 325/2023”. **(Vendimi nr. 59, datë 07.07.2023)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 7 korrik 2023

